



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 136

Prishtinë, më 28.1.2014, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Daut Haradinaj, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Boban Todorović, Ramiz Lladrovci.

Mungoi : Anëtar i VV ende nuk është emëruar.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 21.1.2014,
3. Shqyrtimi i Planit hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”,
4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2014,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime duke u përkrahur nga komisioni shqyrtimi i tre projektligjeve në parim, të cilat plotësojnë kushtet për përcjellje në leximin e parë.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.1.2014

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 21 janar 2014.

3. Shqyrtimi i Projektligjeve në parim, për infrastrukturën kombëtare të informacionit hapësinor të Republikës së Kosovës, për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 127 për regjistrimin e bujqësisë dhe për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore

Kryetari njoftoi komisionin se këto projektligje janë dërguar nga Qeveria dhe të njëjtit kanë të bëjnë me disa ndryshime të vogla, si janë ndryshim i datave etj, ndaj edhe sugjeroi që komisioni të përcjelli mbledhjes plenare rekomandimet për leximin e parë të tyre, për çka u vendos si vijon

R e k o m a n d i m

Të miratohen në parim nga mbledhja plenare :

1. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. L-127 për Regjistrimin e bujqësisë,
2. Projektligji për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës, dhe
3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/ L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore

4. Shqyrtimi i Planit hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”

Kryetari Nait Hasani njoftoi fillimisht komisionin për Planin Hapësinor Sharri që ka arrite nga Qeveria dhe drejtat e këtij komisionit për ta shqyrtuar dhe vlerësuar a ka nevojë të shqyrtohet ende duke organizuar dëgjime publike apo të procedohet për mbledhje plenare. Ai kishte disa vërejtje, sidomos në faqet 96 dhe 97 ku është dashur të flitet për investimet konkrete por ato faqe mungojnë, gjithashtu njoftoi për kërkesën e disa OJQ-ve që kanë kërkuar shtyrjen e miratimit nga ky komision të këtij plani, ngase duhet pasur një arsyetim më të mirë dhe të organizohen dëgjimet publike. MMPH , vazhdoi ai, këtë plan ka filluar të hartoi qysh në vitin 2007, mirëpo Qeveria ka ndërruar kahen e duhur në vitin 2011 kur e ka shpallë zonën e këtij parku si zonë e interesit ekonomik, ndaj sugjeroi anëtarët e komisionit për përgjegjësi duke kërkuar që të lihet vend për shqyrtim adekuat.

Daut Haradinaj fillimisht potencoi se fjala është për një plan dhe jo për ligj, pastaj rikujtoi anëtarët se koha e dëgjimeve publike ka kaluar në fazat e mëhershme të hartimit të këtij plani nga Qeveria e Republikës së Kosovës, propozoi dërgimin e planit për mbledhje plenare ku do të vendoset përfundimisht.

Ramiz Lladrovci në cilësinë e anëtarit të ri të Komisionit përshëndeti dhe u pajtua me parafolësin dhe tha se dokumenti në fjalë nuk është Projektligj por Plan Hapësinor. Plani Hapësinor nuk ka nevojë të miratohet me dy lexime por vetëm me një lexim (njëlloj sikurse Plani Hapësinor për Kleçkë dhe Divjake, Plani Hapësinor për Zonën e Veçantë “Fusha e Mihjes së Re” dhe Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020). Komisioni mund të vendosë të mbajë dëgjim publik apo të ftojë ekspertë sipas Nenit 66 të rregullores së punës së Kuvendit, mirëpo kjo nuk është e detyrueshme, posaçërisht duke marrë parasysh që ky plan hapësinor ka qenë në shqyrtim nga ekspertët që nga viti 2009 si dhe i është nënshtruar procesit zyrtar të dëgjimeve publike nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor gjatë periudhave që u cekën nga deputeti Daut Haradinaj, propozoi të dërgohet për mbledhje plenare për miratim.

Sevdije Lama i dëshiroj mirëseardhje anëtarit të ri të komisionit ndërkaq rreth miratimit të këtij plani rikujtoi komisionin se edhe planet tjera në këtë komision janë miratuar me një veprim, përkatësisht lexim, ndaj propozoi sikurse dy parafolësit të dërgohet mbledhjes plenare për miratim.

Salih Morina ishte i mendimit se kemi të bëjmë me një projekt strategjik për zhvillimin ekonomik të vendit me 4000 vende të reja të punës duke krijuar përfitime financiare prej 5 miliardëve në periudhën 10 vjeçare, ndaj edhe meriton të miratohet, ndërsa për mangësitë në dokumentin me shkrim që potencohen nga kryetari, sugjeroi të ftohet ministri dhe të pytet për shkakun, në mbledhjet e radhës së komisionit.

Rasim Demiri gjithashtu propozoi sikurse anëtarët e deritanishëm që të dërgohet plani për miratim në mbledhjen plenare, ndërkaq **Boban Todoroviq** lidhur me këtë shtoi edhe arsyen se në Evropë do të depërtoji njoftimi për potencialet e mira të Kosovës për turizëm dimëror, nëse mirtohet ky plan dhe nuk ka arsye pse mos të miratohet.

Nait Hasani në emër të demokracisë parlamentare sqaroi se duhet shprehur mirëkuptim për kërkesat e shoqërisë civile ngase do të shkatërrohet gjelbërimi në fushat më të mira që ka Kosova dhe do të bëhen prerjet e pishave ku nuk ka borë në sezonin për çka kërkohet, megjithatë reagoi **Daut Haradinaj** se Kuvendi nuk mund të shndërrohet në fontanë dëshirash.

Luan Nushi nga departamenti përgjegjës i MMPH theksoi se hartimi i këtij plani është vonuar për shkak të bashkëngjitjes së territorit nga Dragashi, ndërkaq në zonën e tretë të zhvillimit të kontrolluar e cila përfshin 7% të territorit të parkut është kjo sipërfaqe për të cilën këtu sot debatohet. Derisa “edhe ne” si tha drejtori, “kemi qenë për mosmiratim për shpallje si zonë e tretë”, nga Qeveria na ka ardhë vendimi i cili për MMPH është obligative, përfundoi ai.

Në vazhdim u zhvilluan diskutime lidhur me këtë plan Hapësinor midis **Ramiz Lladrovci**, **Nait Hasanit**, **Daut Haradinaj**, **Sevdije Lama** dhe **Salih Morina** si vijon :

- **Ramiz Lladrovci**: Ne jemi në demokraci dhe besojë se mbaruan diskutimet dhe nuk duhet të vonohemi me shqyrtime të mëtejme por propozoi ta hidhni në votim dhe komisioni të vendos a duhet të ketë debat publik për këtë plan Hapësinor apo do t'i dërgohet Kuvendit dhe Kuvendi pastaj do të vendos për po ose jo.
- **Nait Hasani** : vendi ynë është përkrahës i shumë direktivave të BE për mbrojtjen e natyrës (i numëroi disa direktiva), biodiversitetit etj.
- **Daut Haradinaj** : askush nuk po kundërshton për shqyrtime që duhet të bëhen, por ku kanë qenë këta OJQ me rastin e organizimit të dëgjimeve në procedurat e mëhershme që nga viti 2009, si mund të mbrohet natyra nëse Kosovarët shkojnë në pushime dimërore në Mavrovë apo Bansko të Bullgarisë, ne do të jemi përgjegjës nëse e hedhim këtë projekt për investime në Kosovë ngase vetëm në këtë pjesë-grykë- kemi borë gjatë periudhës 5 mujore, ne jemi mësua vetëm të shesim, ne duhet të zhvillojmë disi ekonominë ku donatori do të ketë përgjegjësinë edhe për mbrojtjen e natyrës. Sa i përket shkatërrimeve të pyjeve ne jemi vet fajtorë, si të interpretohet për shembull mos blerja e një makine prej 33.000 euro për shuarje të zjarreve që kishim dhe që do të kemi ende në vazhdimësi zjarre. A nuk është shumë nëse ja shtojmë këtyre neglizhencave edhe një bllokim për investime dhe licenca (me vend e pavend) për shumë gurthyes, pra unë ju lus mos të pengojmë këtë investim mbi 400 milion euro.
- **Nait Hasani** : shikoni më saktë dokumentin ku flitet për investime 3 milion (Kaqanik-qendra turistike Bushi në Luboten), pra me vetëdije po bëjmë shkelje procedurale.
- **Sevdije Lama** : pse po përdoret termi shkatërrim kur kemi investime sipas procedurave të ligjeve të Kosovës dhe mbrojtje të natyrës ku i konvenon donatorit ndërtimi adekuat,
- **Salih Morina** : deri tani ky komision gjithmonë ka vepruar me konsensus, ndaj edhe në këtë rast duhet të jemi pro ngase për padrejtësi eventuale duhet ta lëmë fjalën mbledhjes plenare.

Kryetari Nait Hasani ftoi Komisionin për rekomandim, ndërkaq Komisioni vendosi si vijon (7 vota për, kryetari kundër) :

R e k o m a n d i m

Të miratohet Plani hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”.

5. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2014

Lidhur me planin e sivjetmë të komisionit, kryetari **Nait Hasani** njoftoi se është mbajtur takimi me mbështetësit e komisionit, ku GAP ka shprehë interesimin për të mbështetur komisionin rreth monitorimit të Ligjit për Inspektoratë bujqësore (të hyj në plan) kurse REC për Ligjin e ajrit, si dhe të bëhet iniciativa në MB për Ligjin e pyjeve të hartohet më herët sesa që është parapa në strategji të Qeverisë, **Ramiz Lladrovci** tha se Plani i punës së Komisionit për vitin 2014 është planë një vjeçare, ftoi të votohet ky që është paraqitur dhe si vërejtje tha se plani mund të plotësohet gjatë punës nga ana e komisionit, ndaj pasi që nuk kishte plotësime të reja nga anëtarët e komisionit u vendos :

P Ë R F U N D I M

MIRATOHET plani i punës së Komisionit për vitin 2014.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani